



OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË – SHKOLLA E MESME

Viti mësimor 2020-2021

Faza e tretë

Skemë Vlerësimi

PYETJA 1.

A. 2 pikë/

Pas heqjes së skllavërisë në vitin 1865, një sërë ligjesh të emërtuara si “Kodet e Zeza “ nisën të miratohen në SHBA, të cilat sollën gradualisht ndarjen mes të bardhëve dhe popullsisë me ngjyrë të cilat e veçonin këtë popullsi , ata kishin shkollat e tyre, zonat e tyre në parqe, vendet e tyre në autobus etj.

Këto ligje u njohën si “Ligjet Jim Crow”.

Nxënësi merr 2 pikë: Nëse jep një arsye pse ka një ndarje mes të të bardhëve dhe njerëzve me ngjyrë në autobus, dhe emërton se kjo ndarje I referohet “Ligjet Jim Crow”.

Nxënësi merr 1 pikë: Nëse jep një arsye pse ka një ndarje mes të të bardhëve dhe njerëzve me ngjyrë në autobus ose emërton se kjo ndarje I referohet “Ligjet Jim Crow”.

Nxënësi merr 0 pikë: Nëse nuk jep asnjë arsye pse ka një ndarje mes të të bardhëve dhe njerëzve me ngjyrë në autobus, dhe as nuk emërton se kjo ndarje I referohet “Ligjet Jim Crow”.

B. 2 pikë

Përmes ligjeve të veçimit:

1. ndaloheshin martesat mes personave që nuk kishin të njëjtën ngjyrë.
2. Bizneset dhe vendet e shërbimit krijuan zona të veçanta ku u shërbehej njerëzve me ngjyrë.
3. Njerëzit me ngjyrë ishin të detyruar të ndiqnin shkolla të posaçme vetëm për ta pa u përzier me të bardhët,
4. Ata kishin zonat e tyre të pushimit në park, zonën e pritjes në stacionet e trenave, aeroporteve, porteve etj.
5. Transporti public gjithashtu e theksonte veçimin, pasi lejonte uljen e njerëzve me ngjyrë vetëm në sediljet e fundit të autobusave dhe lirimin e tyre në rast të afrimit të një të bardhi.
6. Gama e punëve që mund të kryheshin nga njerëzit me ngjyrë ishte e kufizuar kryesisht në shërbëtorë, pastrues, kujdestarë fëmijësh, punëtorë minierash, punëtorë fabrikash etj.

Nxënësi merr 2 pikë: Nëse jep katër nga shembujt e mësipërm (ose të ngjashëm me to) për ilustrim se si kufizoheshin të drejtat e njerëzve me ngjyrë në SHBA.

Nxënësi merr 1 pikë: Nëse jep dy nga shembujt e mësipërm (ose të ngjashëm me to) për ilustrim se si kufizoheshin të drejtat e njerëzve me ngjyrë në SHBA.

Nxënësi merr 0 pikë: Nëse jep vetëm një/ose asnjë , nga shembujt e mësipërm (ose të ngjashëm me to) për ilustrim se si kufizoheshin të drejtat e njerëzve me ngjyrë në SHBA.

C. **2 pikë**

Rosa Park, refuzoi t'i lironte vendin një të bardhi në një autobus në Montgomery, Alabama në vitin 1955. Qëndrimi i saj çoi në arrestimin e saj në 1 dhjetor 1955. Arrestimi i saj nxiti fillimin e një lëvizjeje të re, që u shfaq me bojkotin e autobusëve. Pas arrestimit Rosa Park kaloi në një process gjyqësor. Edhe pas lirimit të saj ajo pati shumë vështirësi; kërcënime, humbi punën dhe kësisoj u largua nga Alabama dhe u vendos në Detroit. Ajo njihet si nëna e Lëvizjes për të Drejtat Civile në SHBA.

Nxënësi merr 2 pikë: Nëse jep shembullin e Rosa Park ose te ngjashëm me veprimet e saj (përfshirë Bayard Rustin në vitin 1942, Irene Morgan në vitin 1946, Lillie Mae Bradford në vitin 1951, Sarah Louise Keys në vitin 1952, të cilët refuzuan t'i lironin vendin një të bardhi në një autobus në Montgomery, Alabama) dhe përcakton se ky qëndrim çoi në arrestimin e Rosa Park në 1 dhjetor 1955 që nxiti fillimin e një lëvizjeje të re për të Drejtat Civile në SHBA.

Nxënësi merr 1 pikë: Nëse jep shembullin e Rosa Park ose te ngjashëm me veprimet e saj (përfshirë Bayard Rustin në vitin 1942, Irene Morgan në vitin 1946, Lillie Mae Bradford në vitin 1951, Sarah Louise Keys në vitin 1952, të cilët refuzuan t'i lironin vendin një të bardhi në një autobus në Montgomery, Alabama) ose kur nxënësi përcakton se ky qëndrim nxiti **fillimin e një lëvizjeje të re për të Drejtat Civile në SHBA.**

Nxënësi merr 0 pikë: Nëse **nuk** ilustron me asnje nga ngjarjet në autobus në Montgomery, Alabama ose kur nxënësi **nuk** përcakton se ky qëndrim nxiti **fillimin e një lëvizjeje të re për të Drejtat Civile në SHBA.**

D. **1 pikë**

Rosa Park, pasi refuzoi t'i linte vendin një të bardhi në autobus. Lëvizja nisi në ditën e arrestimit të saj 1 dhjetor 1955. Edhe pse Rosa ishte nxitja për fillimin e Lëvizjes, rolin kryesor për organizimin dhe drejtimin e saj e pati Martin Luter King.

Nxënësi merr 1 pikë: Nëse indentifikon emrin e Rosa Park si symbol i Lëvizjes për të Drejtat Civile në SHBA.

Nxënësi merr 0 pikë: Nëse nuk indentifikon emrin e Rosa Park si symbol i Lëvizjes për të Drejtat Civile në SHBA.

E. **3 pikë**

Nxënësi jep përgjigje duke përmendur fakte të ndryshme, të cilat vënë në dukje ndryshimet që pësoi SHBA pas zhvillimit të Lëvizjes për të Drejtat e Njeriut, të drejtuar nga Martin Luter King në vitet 50-60 të shek. XX. Mes të tjerave nxënësi mund të përmendë:

1. U shfuqizua Ligji për Shkolla të veçuara. Tashmë zezakë e të bardhë mund të shkojnë në të njëjtën shkollë.
2. Mori fund praktika e ndarjes në autobusë, parqe, stacione etj, që kishin përcaktuar zona të veçanta për njerëzit me ngjyrë.
3. Në vitin 1964 me ligj u vendos se nuk do të kishte ndarje në vendet publike: tualete, dyqane, restorante, parqe, kinema etj.
4. Në vitin 1968, ligji lejoi regjistrimin e zezakëve për të votuar. Njerëzit me ngjyrë mund të kandidonin dhe të bëheshin pjesë aktive e politikës amerikane. Shëmbulli perfekt për këtë është zgjedhja e Barack Obama si president i SHBA-së.

Nxënësi merr 3 pikë: Nëse jep tre nga katër drejtimet e arritjeve që solli **Lëvizja për të Drejtat Civile.**

Nxënësi merr 2 pikë: Nëse jep dy nga katër drejtimet e arritjeve që solli **Lëvizja për të Drejtat Civile.**


Nxënësi merr 1 pikë: Nëse jep një nga katër drejtimet e arritjeve që solli **Lëvizja për të Drejtat Civile.**

Nxënësi merr 0 pikë: Nëse nuk jep asnjë nga katër drejtimet e arritjeve që solli **Lëvizja për të Drejtat Civile.**



PYETJA 2.

8 pikë



Nxënsi/sja mund të mbajë qëndrim “Pro”, “kundër” ose dhe të jetë i lëkundur lidhur me fenomenin në fjalë. Në secilin rast, ai/ajo duhet të sjellë fakte që mbështesin idenë dhe qëndrimin e tij/saj. Ja disa nga sugjerimet:

Pro Globalizmit	Kundër Globalizmit
<ol style="list-style-type: none"> 1. Nxiti zhvillimin e lirë të ekonomisë globale. 2. Hap vende të reja pune, sidomos në vendet e botës së pazhvilluar. 3. Nxiti konkurrencën midis kompanive. Konkurrenca sjell çmime më të ulta. 4. U mundëson zonave të varfëra të planetit zhvillim dhe prosperitet. 5. Nxiti specializimin e shteteve përsa i përket prodhimeve dhe lehtëson shitjen e tyre në tregun botëror. 6. Ndarja e ideve, përvojave dhe stileve të jetës së njerëzve dhe kulturave. Njerëzit mund të provojnë gjëra të reja që nuk i gjenin më parë në vendin e tyre. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndodh dominimi i ndërmarrjeve gjigande që kanë fuqinë politike dhe financiare për të përzënë rivalët e vegjël nga biznesi. 2. Shkatërrimi i mjedisit duke promovuar teknologji të paqëndrueshme për mjedisin. 3. Shkatërron vendet e punës në ekonomitë e pasura dhe të përparuara, Kompanitë mbyllin filialet në vendet e zhvilluara dhe i hapin ato në vendet në zhvillim ku pagat janë më të ulëta. 4. Zgjeron hendekun midis të pasurve dhe të varfërve si brenda dhe midis kombeve. 5. Mund të çojë në amerikanizim politik, ekonomik dhe kulturor të botës.

<p>7. Mund t'i ndihmojë njerëzit që të jenë më të vetëdijshëm për çështjet globale si psh: shpyllëzimet dhe ngrohja globale dhe t'i nxisë ata për gjetjen e mënyrave efektive drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.</p> <p>8. Përmirëson gjendjen e grave dhe zvogëlon hendekun e pagave midis kombeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim.</p> <p>9. Krijon kushtet në të cilat mund të lulëzojë demokracia dhe respekti për jetën njerëzore</p> <p>10. Etj.</p>	<p>6. Zhvendos fuqinë nga qeveritë nacionale drejt institucioneve si p.sh., Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bashkimi Evropian (BE), etj.</p> <p>7. Humbet diversiteti kulturor, për shkak të krijimit të një bote gjithmonë e më të ngjashme.</p> <p>8. Është një formë e kolonializmit modern, ku shtete të fuqishme drejtojnë dhe kontrollojnë vendet më të dobta.</p> <p>9. Etj.</p>
---	---

Nxënësi merr 8 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë tetë nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 8 pikë: nëse mban të dyja qëndrimet e kërkuara por duke sjellë katër nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to për secilin qëndrim.

Nxënësi merr 7 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë shtatë nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 7 pikë: nëse mban të dyja qëndrimet e kërkuara por duke sjellë tre nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to për secilin qëndrim dhe e lidh me imazhin e dhënë.

Nxënësi merr 6 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë gjashtë nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 6 pikë: nëse mban të dyja qëndrimet e kërkuara por duke sjellë tre nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to për secilin qëndrim.

Nxënësi merr 5 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë pesë nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 5 pikë: nëse mban të dyja qëndrimet e kërkuara por duke sjellë dy nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to për secilin qëndrim dhe i lidh ato me imazhin e dhënë.

Nxënësi merr 4 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë katër nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 4 pikë: nëse mban të dyja qëndrimet e kërkuara por duke sjellë dy nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to për secilin qëndrim.

Nxënësi merr 3 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë tre nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 3 pikë: nëse mban të dyja qëndrimet e kërkuara por duke sjellë një nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to për secilin qëndrim dhe i lidh ato me një nga imazhet e dhëna.

Nxënësi merr 2 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë dy nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 2 pikë: nëse mban të dyja qëndrimet e kërkuara por duke sjellë një nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to për secilin qëndrim.

Nxënësi merr 1 pikë: nëse mban njërin nga qëndrimet e kërkuara por duke sjellë një nga faktet e përmendura më sipër ose të ngjashme me to.

Nxënësi merr 0 pikë: nëse nuk mban asnjë nga qëndrimet e kërkuara dhe nuk i lidh llogjikisht faktet me një nga imazhet e dhëna.

PYETJA 3

10 pikë

A.

Winston Churchill, Franklin Ruzvelt, Josif Visarianoviç Stalin. Tre të mëdhenjtë, përfaqësues të Britanisë së Madhe, SHBA-së dhe BRSS-së. Aletatë përgjatë Luftës së Dytë Botërore.

B.

Është një imazh i animuar që është realizuar në kuadër të veprimtarisë diplomatike të “Tre të Mëdhenjve”, gjatë LIIB. Në këtë rast, imazhi i referohet punimve të Konferencës së Jaltës.

C.

Për të dhënë një përgjigje sa më të plotë për këtë pyetje nxënësi/sja duhet të vëzhgojë me kujdes detajet e imazhit: termometrin, fashën në kokë, fytyrën e lodhur, buzëqeshjen në fytyrën e botës, mimikën e Tre të mëdhenjve etj.

Ps h.

Termometri dhe koka e fashuar, lodhja në imazhin e “Botës”, tregon vështirësitë dhe problemet që ajo ka pas vendosjes së nazizmit, Fashizmit dhe afro 6 viteve luftime.

Ndërkohë, vetullat e ngritura lart, një buzëqeshje e vogël por e dukshme, sytë e nriçuar tregojnë për shpresën që ekziston. Hitleri është drejt dorëzimit, edhe pak luftë ka mbetur. Fashizmi dhe nazizmi po rrëzohen.

Tre të mëdhenjtë janë në rolin e mjekëve, madje Stalini po i mat “pulsin”, ata janë të kujdesshëm, të shqetësuar dhe të gatshëm për ‘pacientin e tyre’. Pra Bota është e sigurt në duart e tyre. Përmes këtij imazhi, njerëzve të botës u përcilet imazhi që “Tre të mëdhenjtë” janë garancia për arritjen e fitores mbi nazifashizmin.

Në vlerësimin e artikullit tuaj do të vlerësohen këto elementë:

Titulli (1pikë)

Paragrafi kryesor-hyrje (2pikë),

Përmbajtja e artikullit (3pikë)

Konkluzione përmbyllës (3pikë)

Rregullat drejtshkrimore (1pikë)



Nxënësi merr dhjetë pikë: nëse ka realizuar artikullin me të gjitha kriteret titullin, paragrafin kryesor(hyrje), përmbajtjen e artikullit, konkluzionin përmbyllës në koherencë me imazhin e dhënë, faktet historike që pasqyron dhe përdor saktë rregullat drejtshkrimore.

PYETJA 4.

Për vlerësimin e esesë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

Kompetenca	Teza	Antiteza	Argumente	Kunderargumente	Struktura
Pikët	1 pikë/	1 pikë/	4 pikë/	4 pikë/	5 pikë/

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

4 pikë/

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- përshkruan një situatë ku ai zgjedh të prezantojë tezën dhe antitezën.
- përdor sa më shumë detaje dhe fakte konkrete, për të mbështetur tezën dhe për të kundërshtuar antitezën.
- tema zhvillohet në mënyrë të plotë përmes referimit të faktet dhe të dhënat historike.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

6 pikë

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- respekton elementet e strukturës së esesë: - hyrjen; - zhvillimin (paragrafët ku përshkruhen çështjet e planifikuara në temën e esesë); - përfundimin.

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- siguron organizim logjik të shkrimit, përmes shfrytëzimit të teknikave të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri), si dhe përdor saktë termat historikë dhe kronologjinë e ngjarjes.

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

5 pikë

Nxënësi shkruan një ese, ku:

- përdor një gjuhë të qartë për të krijuar një panoramë të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike, të pasur me detaje të llojit përshkrues, analizues dhe faktesh;
- dëshmon pasuri fjalori historik;

PYETJA 5

7 pikë

A.

2 pikë

- 1- Lufta Antifashiste në vend çliroi vendin nga pushtuesit nazifashistë dhe rikonfirmoi pavarsinë e Shqipërisë. Në pushtet kishin ardhur forcat që bënë luftën, ato që kishin qënë pjesë e Frontit Nacionalçlirimtar, ku prioritet merrte Partia Komuniste. Fakti që në zgjedhje Partia Komuniste u fsheh nën emrin Fronti Demokratik i shumëfishoi pritshmëritë e shqiptarëve për zhvillim të një demokracisë liberale. Ky ishte mendimi që dominonte te masa e gjerë popullore. Në radhët e intelektualëve të vendit, u ndje dyshimi dhe shqetësimi se sistemi që sapo u vendos ishte antidemokratik dhe me prirje të staliniste. Nga ana tjetër, pritej një rimëkëmbje e shpejtë e ekonomisë së vendit, përmes kryerjes së reformave që do ta mundësonin këtë. Pritej me padurim Reforma Agrare e premtuar që në periudhën e luftës, përmes të cilës u konfiskohej toka të pasurve dhe u shpërndahej fshatarëve, sipas Ligjit të 29 gushtit 1945.
2. Të tilla masa, sollën pakënaqësitë e para kundër regjimit, të cilat u shfaqën përmes lëvizjeve opozitare brenda Asamblesë Kushtetuese, aktivizimin e grupeve antikomuniste në very dhe në jug të vendit, nisën kryengritje të armatosura antikomuniste (e Postribës, e Zhapokikës etj), u formuan oraganizata ilegale të cilat synuan përmbysjen e regjimit komunist. Etj.

Nxënësi merr 2 pikë: nëse e mbështet përgjigjen e tij tek të dyja faktet e mësipërme ose të ngjashme me to dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore.

Nxënësi merr 1 pikë: nëse e mbështet përgjigjen e tij tek njëra nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore.

Nxënësi merr 1 pikë: nëse jep pjesërisht secilën prej fakteve të mësipërme dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore.

Nxënësi merr 0 pikë: nëse nuk e mbështet përgjigjen e tij tek njëra nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to ose nuk jep asnjë përgjigje.

B.

2 pikë

Nxënësi/sja mbështetet në këto pika:

1. Që në fillim Fuqitë e Mëdha patën dyshime kundrejt regjimit komunist që u vendos në Shqipëri. Kështu kërkesës së Shqipërisë për të qënë pjesëmarrëse në Konferencën e San Françiskos gjatë të cilës u formua OKB, Fuqitë e Mëdha nuk i'u përgjigjën pozitivisht. SHBA dhe Britania e Madhe, hodhën akuza për mënyrën e organizimit të zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, ndaj njohja e qeverisë shqiptare nuk u shoqërua me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Incidenti i Kanalit të Korfuzit e vështirësoi edhe më shumë pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë. Marrëdhëniet me SHBA dhe Britaninë e Madhe u ftohën edhe më tepër. Këto vende me Shqipërinë, i ndanin paragjykimet politike dhe ideologjike.

2. Ndërkohë, regjimi komunist në vend u mbështet që në fillësë të tij nga Jugosllavia dhe BRSS dhe vendet e Bllokut Lindor, të cilat i shtrinë Shqipërisë dorën e bashkëpunimit. I vetmi vend përëndimor që njohu qeverinë shqiptare ishte Franca.

Nxënësi merr 2 pikë: nëse e mbështet përgjigjen e tij tek të dyja faktet e mësipërme ose të ngjashme me to dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore.

Nxënësi merr 1 pikë: nëse e mbështet përgjigjen e tij tek njëra nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore

Nxënësi merr 1 pikë: nëse jep pjesërisht secilën prej fakteve të mësipërme dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore.

Nxënësi merr 0 pikë: nëse nuk e mbështet përgjigjen e tij tek njëra nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to ose nuk jep asnjë përgjigje.

C,D, E

3 pikë

1-Regjimi i Enver Hoxhës ka qënë më i ashpri në Europën Lindore sepse krijoi një vend të izoluar jo vetëm nga pjesa tjetër e botës, por edhe mes vetë Europës Lindore.

2-Politika e izolimit total, mënjanoi shqiptarët nga zhvillimet e pjesës tjetër të botës.

-Regjimi komunist prodhoi një frikë të rrënjosur fort në mendësinë e banorëve të Shqipërisë.

3-Partia shtet kishte krijuar një strukturë të fortë drejtuese.

4-Lufta e Klasave kishte eliminuar kundërshtarët e regjimit dhe kishte rrënjosur frikën.

5-Indoktrinimi i masave me idetë komuniste, kishte prodhuar në vend “njeriun e ri”, të bindur për efikasitetin e regjimit.

Nxënësi merr 3 pikë: nëse e mbështet përgjigjen e tij tek tre nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore.

Nxënësi merr 2 pikë: nëse e mbështet përgjigjen e tij tek dy nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore

Nxënësi merr 1 pikë: nëse e mbështet përgjigjen e tij tek një nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to dhe ka shkruar sipas rregullave drejtshkrimore

Nxënësi merr 0 pikë: nëse nuk e mbështet përgjigjen e tij tek asnjëra nga faktet e mësipërme ose të ngjashme me to ose nuk jep asnjë përgjigje.